



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 6, datë 23.03. 2012

**PËR
“DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I TIRANËS PROFESOR DOKTOR
KRISTO FRASHËRIT (AKADEMIK) ”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim Relacionin për “Dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës Profesor Doktor Kristo Frashërit (Akademik), mbështetur në nenin 32, gërma “m”, nenin 7, pika 2, dhe nenin 8/VII, shkronja “a”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës Profesor Doktor Kristo Frashërit (Akademik), me motivacionin:

“Për kontributin e çmuar në evidentimin e vlerave historike të qytetit të Tiranës”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI